

URDHËR
Nr. 146, datë 30.6.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR LLOGARITJEN, PUBLIKIMIN
DHE FORMATIN E PËRZIERJES SË MBETUR DHE TË STRUKTURËS SË
BURIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR KLIENTËVE
FUNDORË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për llogaritjen, publikimin dhe formatin e përzierjes së mbetur dhe të strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi

RREGULLORE
**PËR LLOGARITJEN, PUBLIKIMIN DHE FORMATIN E PËRZIERJES SË MBETUR
DHE TË STRUKTURËS SË BURIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR KLIENTËVE FUNDORË**

Neni 1
Objekti

1. Kjo rregullore përcakton rregullat për llogaritjen, raportimin dhe publikimin e përzierjes së mbetur përfundimtare dhe të strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë.

2. Në këtë rregullore përcaktohen, gjithashtu:

a) detyrimet e pjesëmarrësve në procesin e raportimit të të dhënave të nevojshme për llogaritjen e përzierjes së mbetur përfundimtare;

b) detyrimet e furnizuesve për llogaritjen dhe publikimin e strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë;

c) detyrimet e Entit Rregullator të Energjisë për llogaritjen, miratimin dhe publikimin e përzierjes së mbetur përfundimtare;

ç) formatin dhe afatet e raportimit dhe publikimit të informacionit.

3. Llogaritja e përzierjes së mbetur përfundimtare dhe e strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë kryhet në përputhje me metodologjinë që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje si shtojca 1 dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 2 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 59/2016, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” (në vazhdim, ligji).

2. Në këtë rregullore përdoren, gjithashtu, termat, të cilat kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) “**Atribut**” është karakteristika e energjisë elektrike që identifikon burimin nga i cili është prodhuar ajo energji;

b) “**Garanci Origjine e anuluar (Cancelled Guarantee of Origin – CGO)**” është garancia e origjinës që është anuluar për qëllime të deklarimit të origjinës së energjisë elektrike ndaj klientëve fundorë;

c) “**Përzierja e Mbetur Kombëtare Paraprake (Preliminary Domestic Residual Mix – PDRM)**” është përzierja e energjisë elektrike e llogaritur përpara marrjes në konsideratë të shkëmbimeve ndërkufitare të energjisë elektrike;

ç) “**Përzierja e Mbetur Kombëtare (Domestic Residual Mix – DRM)**” është përzierja e energjisë elektrike e llogaritur sipas metodologjisë, pas marrjes në konsideratë të prodhimit vendas, importeve, eksporteve dhe attributeve të energjisë;

d) “**Përzierja Evropiane e Attributeve (European Attribute Mix – EAM)**” është përzierja e attributeve e krijuar nga kontributet e vendeve që rezultojnë me suficit attributesh, sipas metodologjisë;

dh) “**Përzierja e Mbetur Përfundimtare (Final Residual Mix – FRM)**” është përzierja e energjisë elektrike e llogaritur pas korrigjimit të Përzierjes së Mbetur Kombëtare me Përzierjen Evropiane të Attributeve, sipas metodologjisë;

e) “**Konsum i Pagjurmueshëm (Untracked Consumption – UC)**” është pjesa e konsumit të energjisë elektrike për të cilën nuk janë anuluar garanci origjine ose instrumente të tjera të njohura të gjurmimit të attributeve;

ë) “**Struktura e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë (Supplier Mix – SM)**” është përbërja sipas burimeve të energjisë e energjisë elektrike të furnizuar nga një furnizues, e llogaritur në përputhje me këtë rregullore dhe metodologjinë;

f) “**Modeli tarifar**” është oferta e furnizuesit për klientin fundor, që lidhet me pjesën e burimeve të rinovueshme në energjinë elektrike të furnizuar. Modeli tarifar mund të jetë:

g) **pa strukturë të garantuar** – model me të cilin furnizuesi nuk angazhohet ndaj klientëve fundorë që të sigurojë një pjesë të caktuar ose pjesë, të të gjitha ose individuale, të burimeve të rinovueshme të energjisë në energjinë elektrike të furnizuar; dhe

i) **me strukturë të garantuar** – model me të cilin furnizuesi angazhohet të sigurojë për klientët fundorë një pjesë të caktuar ose pjesë, të të gjitha ose individuale, të burimeve të rinovueshme të energjisë në energjinë elektrike të furnizuar, në bazë të deklaratës për përdorimin e garancisë së origjinës;

gj) “**Suficit i attributeve**” është diferenca pozitive ndërmjet Përzierjes së Mbetur Kombëtare dhe Konsumit të Pagjurmueshëm;

h) “**Deficit i attributeve**” është diferenca pozitive ndërmjet Konsumit të Pagjurmueshëm dhe Përzierjes së Mbetur Kombëtare;

i) “**Kontribut në Përzierjen Evropiane të Attributeve**” është vëllimi i attributeve për secilin burim energjie që transferohet nga një vend me suficit attributesh në Përzierjen Evropiane të Attributeve.

Neni 3

Llogaritja e strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë

1. Për çdo vit kalendarik paraardhës, furnizuesi llogarit strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar:

- a) për të gjithë klientët e tij fundorë;
- b) për klientët fundorë që furnizohen sipas të njëjtit model tarifor.

2. Furnizuesi llogarit strukturën e burimeve të energjisë elektrike, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, sipas parashikimeve të nenit 10, të shtojcës 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Gjatë llogaritjes së strukturës së burimeve të energjisë elektrike, furnizuesi përdor të dhënat e publikuara nga Enti Rregullator i Energjisë në raportin vjetor të përzierjes së mbetur, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 4

Raporti i furnizuesit

1. Për çdo vit kalendarik paraardhës, furnizuesi përgatit raportin mbi strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientit fundor, të llogaritur në përputhje me nenin 3 të kësaj rregulloreje. Raporti i dorëzohet klientit fundor si pjesë përbërëse e faturës së energjisë elektrike, ose së bashku me të, për faturën e muajit qershor të vitit pasardhës.

2. Klienti fundor që ka ndryshuar furnizues gjatë periudhës së raportimit ka të drejtë t'i kërkojë furnizuesit të mëparshëm raportin e përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Furnizuesi është i detyruar t'i dorëzojë klientit fundor raportin e kërkuar sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Për klientët fundorë që kanë më shumë se një pikë matjeje për qëllime faturimi, furnizuesi përgatit një raport të veçantë për secilën pikë matjeje.

5. Kur furnizuesi dhe klienti fundor kanë lidhur më shumë se një kontratë furnizimi me energji elektrike për modele të ndryshme tarifore, por me të njëjtën strukturë të burimeve të energjisë elektrike, furnizuesi mund të përgatisë një raport të vetëm për këto modele tarifore.

6. Kur klienti fundor, gjatë periudhës së raportimit, ka ndryshuar modelin tarifor të furnizimit me energji elektrike pranë të njëjtit furnizues, furnizuesi përgatit dhe i dorëzon raport të veçantë për secilin model tarifor të përdorur.

Neni 5

Formati i raportit

1. Raporti i përcaktuar në pikën 1, të nenit 4, përmban të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) të dhënat identifikuese të klientit fundor;
- b) modelin tarifor të zbatueshëm për klientin fundor;
- c) strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientit fundor, të llogaritur në përputhje me këtë rregullore;
- ç) të dhënat mbi konsumin e energjisë elektrike të klientit fundor, periudhën e furnizimit, pikën e matjes dhe kontratën ose kontratat e furnizimit për të cilat përgatitet raporti;
- d) strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi për të gjithë klientët e tij fundorë;

dh) adresën e faqes zyrtare të internetit të Entit Rregullator të Energjisë ku publikohet raporti vjetor i Përzierjes së Mbetur Përfundimtare, si dhe adresën e regjistrimit të garancive të origjinës;

e) shpjegimet shoqëruese me rëndësi për kuptimin dhe interpretimin e përmbajtjes së raportit për klientin fundor.

2. Të dhënat e përcaktuara në shkronjat “c” dhe “d”, të pikës 1 të këtij neni, paraqiten në formë grafike ose diagrami, sipas kategorive të burimeve të energjisë të përcaktuara në metodologjinë që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

3. Përpara dorëzimit të raportit të klientët fundorë, furnizuesi publikon në faqen e tij zyrtare të internetit, për vitin kalendarik paraardhës:

a) strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar për të gjithë klientët e tij fundorë;

b) strukturën e energjisë elektrike të mbuluar nga garancitë e origjinës të anuluar; dhe

c) adresën e faqes zyrtare të internetit të Entit Rregullator të Energjisë ku publikohet raporti vjetor i Përzierjes së Mbetur Përfundimtare, si dhe adresën e regjistrit të garancive të origjinës.

Neni 6

Llogaritja e përzierjes së mbetur përfundimtare

1. ERRE llogarit përzierjen e mbetur përfundimtare, në përputhje me metodologjinë për llogaritjen e përzierjes së mbetur dhe të strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur, në bazë të të dhënave për:

a) prodhimin vendas të energjisë elektrike sipas burimeve të energjisë, në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 2 të metodologjisë bashkëlidhur kësaj rregulloreje;

b) konsumin vjetor të energjisë elektrike;

c) importet dhe eksportet fizike të energjisë elektrike;

ç) shkëmbimin e attributeve me Përzierjen Evropiane të Attributeve, në përputhje me metodologjinë;

d) garancitë e origjinës të anuluar dhe ato të skaduara; dhe

dh) çdo të dhënë tjetër të nevojshme.

2. Për qëllimet e llogaritjes të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, jo më vonë se data 1 mars, i dorëzojnë ERRE-s të dhënat e përcaktuara në shkronjat: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, të pikës 1 të këtij neni, për vitin kalendarik paraardhës.

Neni 7

Raporti i Entit Rregullator të Energjisë

1. ERRE, brenda datës 20 qershor të çdo viti, miraton dhe publikon në faqen e tij të internetit raportin vjetor për përzierjen e mbetur përfundimtare të vitit kalendarik paraardhës.

2. Raporti i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përmban:

a) të dhëna mbi prodhimin vendas, konsumin, importet dhe eksportet fizike të energjisë elektrike, sipas burimeve të energjisë;

b) të dhënat mbi garancitë e origjinës të lëshuara, të anuluar dhe të skaduara;

c) të dhënat mbi përzierjen e mbetur kombëtare, paraprake, përzierjen e mbetur kombëtare, konsumin e pagjurmueshëm, suficitin ose deficitin e attributeve, përzierjen evropiane të attributeve dhe përzierjen e mbetur përfundimtare, sipas metodologjisë së përcaktuar në shtojcën 1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje; dhe

ç) strukturën sipas burimeve të energjisë së përzierjes të mbetur përfundimtare.

3. ERRE, gjatë përgatitjes së raportit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, përdor kategoritë e burimeve të energjisë të përcaktuara në nenin 2 të metodologjisë për llogaritjen e përzierjes së mbetur dhe të strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë.

4. Përzierja e mbetur përfundimtare e publikuar nga ERE, është e detyrueshme për t'u përdorur nga të gjithë furnizuesit gjatë llogaritjes së strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë.

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E PËRZIERJES SË MBETUR DHE TË STRUKTURËS SË BURIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË FURNIZUAR KLIENTËVE FUNDORË

Neni 1
Objekti

1. Kjo metodologji përcakton rregullat dhe mënyrën e llogaritjes së Përzierjes së Mbetur Kombëtare, Përzierjes Evropiane të Atributeve, Përzierjes së Mbetur Përfundimtare, si dhe të strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë.
2. Kjo metodologji përcakton gjithashtu:
 - a) renditjen e burimeve të energjisë për qëllime të llogaritjeve;
 - b) mënyrën e llogaritjes së konsumit të pagjurmueshëm të energjisë elektrike;
 - c) mënyrën e përcaktimit të suficitit dhe deficitit të attributeve;
 - ç) mënyrën e llogaritjes së kontributit në Përzierjen Evropiane të Atributeve;
 - d) mënyrën e përdorimit të Përzierjes së Mbetur Përfundimtare për përcaktimin e strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë.

Neni 2

Renditja e burimeve të energjisë për qëllime të llogaritjeve

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj metodologjie, të gjitha llogaritjet që lidhen me atributet, Përzierjen e Mbetur Kombëtare (DRM), Përzierjen Evropiane të Atributeve (EAM), Përzierjen e Mbetur Përfundimtare (FRM) dhe strukturën e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë kryhen duke përdorur të njëjtën renditje të burimeve të energjisë.
2. Vëllimet dhe pjesët relative të burimeve të energjisë në të gjitha formulat, matricat dhe llogaritjet matematikore paraqiten sipas renditjes së mëposhtme:
 - a) energjia diellore;
 - b) energjia e erës;

- c) energjia hidrike;
 - ç) energjia gjeotermale;
 - d) energjia nga biomasa;
 - dh) energjia nga burime të rinovueshme me burim të papërcaktuar;
 - e) energjia nga qymyri i gurit;
 - ë) energjia nga qymyri kafe dhe linjiti;
 - f) energjia nga gazi natyror;
 - g) energjia nga nafta dhe derivatet e naftës;
 - gj) energjia nga lëndë djegëse fosile me burim të papërcaktuar;
 - h) energjia bërthamore.
3. Renditja e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni përdoret në mënyrë të pandryshueshme në të gjitha llogaritjet, formulat dhe paraqitjet matricore të kryera në zbatim të kësaj metodologjie.

Neni 3

Llogaritja e Përzierjes së Mbetur Kombëtare Paraprake

1. Për çdo burim energjie, Përzierja e Mbetur Kombëtare paraprake (PDRM), e cila nuk përfshin shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike, llogaritet sipas formulës:

$$PDRM_x = P_x - IA_x + EA_x$$

ku:

- P_x është prodhimi vendas i energjisë elektrike nga burimi i energjisë "x";
 - IA_x janë atributet e lëshuara për burimin përkatës;
 - EA_x janë atributet e skaduara për burimin përkatës.
2. Vëllimi total i Përzierjes së Mbetur Kombëtare Paraprake është i barabartë me shumën e vëllimeve të Përzierjes së Mbetur Kombëtare Paraprake për secilin burim energjie, sipas formulës:

$$PDRM = \sum_{x=1}^n PDRM_x$$

Neni 4

Llogaritja e Përzierjes së Mbetur Kombëtare

1. Për çdo burim energjie, Përzierja e Mbetur Kombëtare (DRM), llogaritet duke marrë në konsideratë prodhimin vendas, importet dhe eksportet fizike të energjisë elektrike, si dhe atributet e lëshuara dhe të skaduara, sipas formulës:

$$DRM_x = P_x + PI_x - PE_x + EA_x - IA_x$$

Ku:

- P_x është prodhimi vendas i energjisë elektrike sipas burimit të energjisë;
 - IA_x janë atributet e lëshuara për burimin përkatës;
 - EA_x janë atributet e skaduara për burimin përkatës.
 - PI_x është sasia e energjisë elektrike e importuar fizikisht në sistemin elektroenergetik kombëtar, e atribuar secilit burim energjie në përputhje me metodologjinë e Përzierjes së Mbetur dhe të Përzierjes Evropiane të Atributeve.
 - PE_x është sasia e energjisë elektrike e eksportuar fizikisht në sistemin elektroenergetik kombëtar, e shpërndarë statistikisht ndërmjet burimeve të energjisë në përpjesëtim me peshën që secili burim zë në Përzierjen e Mbetur Kombëtare Paraprake.
2. Vëllimi total i Përzierjes së Mbetur Kombëtare (DRM) llogaritet si shuma e vëllimeve për secilin burim energjie, sipas formulës:

$$DRM = \sum_{x=1}^n DRM_x$$

3. Pjesa relative e secilit burim energjie llogaritet sipas formulës:

$$PR_x = DRM_x / DRM$$

Neni 5

Llogaritja e konsumit të pagjurmueshëm të energjisë elektrike

1. Konsumi i Pagjurmueshëm (UC) përfaqëson pjesën e konsumit të energjisë elektrike për të cilën nuk janë anuluar attribute nëpërmjet instrumenteve të gjurmimit. Ai llogaritet sipas formulës:

$$UC = EC - \sum_{x=1}^n CA_x$$

Ku:

EC – është konsumi vjetor i energjisë elektrike

CA – janë atributet e anulhuara

Neni 6

Përcaktimi i suficitit ose deficitit të attributeve

1. Pas llogaritjes së Përzierjes së Mbetur Kombëtare (DRM) dhe Konsumit të Pagjurmueshëm (UC), përcaktohet nëse vendi rezulton me suficit ose deficit të attributeve.
2. Nëse:

$$DRM > UC$$

vendi konsiderohet se ka **suficit attributesh (SA)**, i cili llogaritet sipas formulës:

$$SA = DRM - UC$$

3. Nëse:

$$DRM < UC$$

vendi konsiderohet se ka **deficit attributesh (DA)**, i cili llogaritet sipas formulës:

$$DA = UC - DRM$$

4. Në rast se Përzierja e Mbetur Kombëtare është e barabartë me Konsumin e Pagjurmueshëm, vendi nuk rezulton as me suficit dhe as me deficit të attributeve.
5. Suficiti i attributeve transferohet në Përzierjen Evropiane të Attributeve, ndërsa deficit mbulohet nga kjo përzierje, sipas kësaj metodologjie.

Neni 7

Kontributi në Përzierjen Evropiane të Atributeve

Vendet që rezultojnë me suficit atributësh kontribuojnë në Përzierjen Evropiane të Atributeve (European Attribute Mix – EAM).

Për çdo burim energjie, kontributi në Përzierjen Evropiane të Atributeve llogaritet duke shumëzuar suficitin e attributeve me peshën relative të burimit përkatës në Përzierjen e Mbetur Kombëtare, sipas formulës:

$$EAC_x = SA \times PR_x$$

ku:

- **EAC_x** – kontributi i burimit të energjisë *x* në Përzierjen Evropiane të Atributeve;
- **SA** – suficiti i attributeve;
- **PR_x** – pjesa relative e burimit të energjisë *x* në Përzierjen e Mbetur Kombëtare.

Neni 8

Llogaritja e Përzierjes Evropiane të Atributeve

1. Përzierja Evropiane e Atributeve (EAM) përbëhet nga kontributet e të gjitha vendeve që rezultojnë me suficit atributësh.
2. Për çdo burim energjie, vëllimi i Përzierjes Evropiane të Atributeve llogaritet sipas formulës:

$$EAM_x = \sum_{y=1}^m EAC_{x,y}$$

ku:

- **EAM_x** – vëllimi i Përzierjes Evropiane të Atributeve për burimin e energjisë *x*;
- **EAC_{x,y}** – kontributi i vendit *y* për burimin e energjisë *x*;
- **m** – numri i vendeve që kontribuojnë në Përzierjen Evropiane të Atributeve.

3. Vëllimi total i Përzierjes Evropiane të Atributeve llogaritet sipas formulës:

$$EAM = \sum_{x=1}^n EAM_x$$

ku:

- **n** – numri i burimeve të energjisë.

4. Pjesa relative e secilit burim energjie në Përzierjen Evropiane të Atributeve llogaritet sipas formulës:

$$PR_x = \frac{EAM_x}{EAM}$$

Neni 9

Përzierja e Mbetur Përfundimtare

1. Përzierja e Mbetur Përfundimtare për vendet me suficit

Për vendet që rezultojnë me suficit atributësh, Përzierja e Mbetur Përfundimtare llogaritet duke zbritur nga Përzierja e Mbetur Kombëtare kontributin përkatës në Përzierjen Evropiane të Atributeve.

Për çdo burim energjie:

$$FRM_x = DRM_x - EAC_x$$

ku:

- **FRM_x** – Përzierja e Mbetur Përfundimtare për burimin e energjisë *x*.

Vëllimi total i Përzierjes së Mbetur Përfundimtare llogaritet sipas formulës:

$$FRM = \sum_{x=1}^n FRM_x$$

Për vendet me suficit, pjesa relative e secilit burim energjie në Përzierjen e Mbetur Përfundimtare mbetet e njëjtë me pjesën relative të tij në Përzierjen e Mbetur Kombëtare.

2. Përzierja e Mbetur Përfundimtare për vendet me deficit

Pas krijimit të Përzierjes Evropiane të Atributeve, vendet që rezultojnë me deficit marrin attribute nga kjo përzierje në përpjesëtim me pjesën relative të secilit burim energjie në Përzierjen Evropiane të Atributeve.

Për çdo burim energjie, sasia e attributeve të marra nga Përzierja Evropiane e Atributeve llogaritet sipas formulës:

$$IEA_x = DA \times PR_x$$

ku:

- IEA_x – atributet e marra nga Përzierja Evropiane e Atributeve për burimin e energjisë x ;
- DA – deficit i attributeve;
- PR_x – pjesa relative e burimit të energjisë x në Përzierjen Evropiane të Atributeve.

Përzierja e Mbetur Përfundimtare për çdo burim energjie llogaritet sipas formulës:

$$FRM_x = DRM_x + IEA_x$$

Vëllimi total i Përzierjes së Mbetur Përfundimtare llogaritet sipas formulës:

$$FRM = \sum_{x=1}^n FRM_x$$

Pjesa relative e secilit burim energjie në Përzierjen e Mbetur Përfundimtare llogaritet sipas formulës:

$$PR_x = \frac{FRM_x}{FRM}$$

Neni 10

Llogaritja e strukturës së burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë

1. Struktura e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi për të gjithë klientët e tij fundorë (**SM**) llogaritet duke kombinuar sasinë e energjisë elektrike të mbuluar nga

garancitë e origjinës të anuluar me Përzierjen e Mbetur Përfundimtare për pjesën e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga garancitë e origjinës, sipas formulës:

$$SM = \frac{CGO + (E_s - \sum CGO) \times FRM}{E_s}$$

ku:

- **SM** – struktura e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar për të gjithë klientët fundorë të furnizuesit;
- **CGO** – sasia e energjisë elektrike e mbuluar nga garancitë e origjinës të anuluar nga furnizuesi gjatë vitit kalendarik paraardhës, për qëllime të deklarimit të origjinës së energjisë elektrike ndaj klientëve fundorë;
- **FRM** – struktura e Përzierjes së Mbetur Përfundimtare;
- **E_s** – sasia totale e energjisë elektrike e furnizuar nga furnizuesi për të gjithë klientët e tij fundorë gjatë vitit kalendarik paraardhës.

2. Në rast se:

$$E_s - \sum CGO < 0$$

për llogaritjen e strukturës së burimeve të energjisë elektrike merret vlera **0** për pjesën e energjisë elektrike që mbulohet nga Përzierja e Mbetur Përfundimtare.

3. Vëllimi i garancive të origjinës të anuluar, i përdorur për llogaritjen e strukturës së burimeve të energjisë elektrike, nuk mund të tejkalojë sasinë e energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë gjatë periudhës përkatëse të raportimit.
4. Struktura e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë që furnizohen sipas të njëjtit model tarifar (**STM**) llogaritet duke kombinuar sasinë e energjisë elektrike të mbuluar nga garancitë e origjinës të anuluar për modelin tarifar përkatës me Përzierjen e Mbetur Përfundimtare, sipas formulës:

$$STM = \frac{CGO_{tm} + (E_{tm} - \sum CGO_{tm}) \times FRM}{E_{tm}}$$

ku:

- **STM** – struktura e burimeve të energjisë elektrike të furnizuar klientëve fundorë që furnizohen sipas të njëjtit model tarifar;

- **CGO_{tm}** – sasia e energjisë elektrike e mbuluar nga garancitë e origjinës të anuluar nga furnizuesi gjatë vitit kalendarik paraardhës, e destinuar për modelin tarifor përkatës;
- **E_{tm}** – sasia totale e energjisë elektrike e furnizuar klientëve fundorë që përdorin të njëjtin model tarifor gjatë vitit kalendarik paraardhës;
- **FRM** – struktura e Përzierjes së Mbetur Përfundimtare.

5. Në rast se:

$$E_{tm} - \sum CGO_{tm} < 0$$

për llogaritjen e strukturës së burimeve të energjisë elektrike merret vlera **0** për pjesën e energjisë elektrike që mbulohet nga Përzierja e Mbetur Përfundimtare.